



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2700/ 4 prot.

Datë 22.12.2022

V E N D I M
Nr. 1281/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.12.2022 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK në procedurën e “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-48273-11-02-2022, me objekt “*Loti 2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore (MM2)*”, me fond limit 1,299,365 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 14.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Fier.

Autoriteti Kontraktor: Spitali Fier
Adresa: Lagja “1 Maji” Rruga “Invalidët e Luftës”, Fier

Ankimues: Operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK
Adresa: Rruga “Don Bosko”, Blloku nr. 1, shkalla nr. 3, kati 1, nr. 4

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1 të nenit 30, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullave të Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I

Rrethanat e çështjes:

I.1. Në datë 03.11.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-48273-11-02-2022, me objekt “Loti 2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore (MM2)”, me fond limit 1,299,365 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 14.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Fier.

I.2. Në datë 14.11.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

I.3. Në datë 22.11.2022 operatorët ekonomikë janë njohur me klasifikimin përfundimtar të ofertave si më poshtë:

- “AQUARIUS MEDICAL” SHPK	1,029,300.00	I skualifikuar
- “O.E.S DISTRIMED” SHPK	1 293 840.00	I kualifikuar

I.4. Më datë 30.11.2022 autoriteti kontraktor publikoi në SPE formularin e njoftimit të fituesit të procedurës së prokurimit.

I.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datë 05.12.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik është protokolluar ankesa me nr. 2700 prot., e operatorit ekonomik "AQUARIUS MEDICAL" SHPK me objekt shfuqizimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me pretendimet se:

Në lidhje me pikën e parë të skualifikimit të shoqërisë tonë nga kjo procedurë prokurimi, ku keni cituar: "skualifikoheni për arsye se nuk keni përmbushur kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST pasi në katalog paraqitur mungojnë artikujt nr. 6 Shiringa 2cc / Shiringe nje perdorimeshe, steril, me Age 23G, 3 pjesë, dhe artikulli nr.9 Shiringa 50cc/ Shiringe nje perdorimeshe, sterile, me Age 20 G, 3 pjesë; Në katalogun paraqitur për artikujt nr. 7 Shiringa një përdorimshe, sterile me age 22G, 3 pjesë dhe nr. 8 Shiringa një përdorimshe, sterile me age 20G, 3 pjesë nuk përcaktohet madhësia e ages si dhe nuk specifikohet nëse shiringat janë një përdorimshe. Në katalogun e paraqitur për artikullin 10 shiringa insulinë/sterile tre pjesëshe, me age 26 G nuk jepen specifikime teknike të cilat duhet të jenë në përputhje me DST"

Për sa i përket kësaj pike të skualifikimit nga AK Spitali i Fierit, e kundërshtojmë pasi është në kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik dhe rregullat e prokurimit publik, në lidhje me këto artikuj që keni përmendur, konkretisht artikujt nr. 6, 7, 8, 9 dhe 10, shoqëria jonë ka paraqitur dokumentacionin në SPE ku kemi deklaruar si kompani prodhuese e cila ka lëshuar autorizimin për pjesëmarrje për këto artikuj është Kompania prodhuese Ningbo Greetmed Medical Instruments me origjine në Kinë, e cila ka caktuar si distributor zyrtar për Shqiperine Kompanine Evfarma, ku kjo e fundit si distributor zyrtar ka dhënë autorizimin për shoqërinë tonë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, ku ndër dokumentet e tjera që kemi paraqitur në SPE është edhe katalogu i artikujve i kompanisë prodhuese Ningbo Greetmed Medical Instruments, ku janë të pasqyruar të gjithë artikujt sipas specifikimeve teknike të parashikuara në DST. Në lidhje me artikujt 6, 7, 8, 9 dhe 10, sqarojmë se këto artikuj janë në katalogun e paraqitur nga ana jonë në SPE dhe konkretisht në file-n me emertimin "16. GREETMED ALL", dhe konkretisht në faqen 33 me kodin GT037-100 për artikujt me nr. 6, 7, 8 dhe 9, dhe me kodin GT037-300 për artikullin nr. 10, artikuj të cilat plotësojnë të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit, si dhe është i perkthyer dhe noterizuar. Këto artikuj kanë të pasqyruara të gjitha specifikimet teknike sipas kerkesave të AK. Gjthashtu për Kompanine prodhuese Ningbo Greetmed Medical Instruments me origjine në Kine në lidhje me artikujt e mësipërm kemi paraqitur edhe dokumnetacionin tjetër shoqërues si ISO, CE dhe DEKLARATAT E KONFORMITETIT ku vërtetojnë standanet ndërkombëtare të cilësisë së artikujve të prodhuar sipas direktivave përkatëse (MDD) për materialet mjekësore.

Nuk arrijmë të kuptojmë pretendimet e anterave te KVO-se në cilin specifikim teknik nuk përmbushin këto artikuj?! Në qoftë se KVO nuk është e qartë dhe nuk është në gjendje të kuptojë pershkrimin e këtyre artikujve në katalogun që kemi paraqitur duhet të konsultohet me mjek ose specilaiste të fushës si dhe gjithashtu ka patur të drejtën dhe detyrimin që të kërkonin sqarime dhe verifikime tek kompania prodhuese sic është parashikohet në DST.

Ne lidhje piken e dytë të skualifikimit të shoqërisë tonë nga kjo procedurë prokurimi, e kundërshtojmë pasi është në kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik dhe rregullat e prokurimit publik, në lidhje me këto artikuj që keni përmendur, konkretisht artikujt nr. 1 Age spinale atraumatike / Pencil point:22G-2 shoqëria jonë ka paraqitur dokumentacionin në

SPE ku kemi deklaruar si kompani prodhuese e cila ka lëshuar autorizimin për pjesëmarrje për këtë artikull është Kompania prodhuese "Zhejiang Runqiang Medical" me origjinë në Kinë, e cila ka caktuar si distributor zyrtar për shitje, import, eksport, tregtim, shpërndarje dhe pjesëmarrje në tendera publik dhe privat e produkteve të tyre Kompaninë GALENA me origjinë në Turqi, ku kjo e fundit si distributor zyrtar ka dhënë autorizimin për shoqërinë tonë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi për artikujt që ajo tregton, e cila ka caktuar si distributor zyrtar për Shqipërinë Kompaninë tonë për të negociuar dhe lidhur kontrata me autoritete shtetërore public dhe privat për mallrat e prodhuara dhe tregtuara nga ana e tyre, ku ndër dokumentet e tjera të lëshuara nga kompania prodhuese që kemi paraqitur në këtë procedurë prokurimi janë edhe dokumentet Autorizimit të Prodhuesit "Zhejiang Runqiang Medical" me origjinë në Kinë lëshuar për kompaninë GALENA me origjinë në Turqi, ku vlefshmëria e këtij dokumenti është për një periudhë 5 vjetore me të drejte rinovimi, si dhe dokumenti i Autorizimit të distributorit GALENA me origjinë në Turqi lëshuar për kompaninë tonë "Aquarius Medical" Shpk, me afat vlefshmërie "pa afat" që nenkupton periudhën e vlefshmërisë së autorizimit të prodhuesit (5 vjet) dhe datë lëshimi 02.03.2018 (që do të thotë është i vlefshëm deri me 02.03.2023) dhe në rastet e rinovimit të autorizimit, kur ndërkohë kohëzgjatja e kontratës për këtë procedurë prokurimi ose afati për zbatimin e kësaj duke filluar nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 31.12.2022. Afati i vlefshmërisë së autorizimit të prodhuesit dhe distributorit të deklaruar sa më sipër e tejkalon afatin dhe kohëzgjatjen e kontratës së kësaj procedure prokurimi e cila është me afat përfundimtar deri më 31.12.2022. Gjithashtu në autorizimin e distributorit është specifikuar dhe numri i telefoni dhe adresa e emailit të tij, ku ju mund të bënit verifikimet dhe sqarimet tuaja për çdo paqartësi, si dhe keni patur të drejtën dhe detyrimin njëkohësisht që të kërkonit sqarime dhe verifikime sic parashikohet në DST në paragrafin e parafundit të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku citohet: (Shënim:ORT rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit).

Ne lidhje me artikullin nr. 2 Formaldehyd / Solucion 3540% shoqëria jonë ka paraqitur dokumentacionin në SPE cila ka lëshuar autorizimin për pjesëmarrje për këtë artikull është Kompania prodhuese "Aqua Medical" me origjinë në Turqi, e cila ka caktuar si distributor zyrtar për Shqipërinë Kompaninë tonë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi dhe në të gjithë procedurat e tjera zhvilluara në territorin e Republikës së Shqipërisë nga autoritete private dhe shtetërore, ku ndër dokumentet e tjera të lëshuara nga kompania prodhuese që kemi paraqitur në këtë procedurë prokurimi është edhe dokumenti i Autorizimit të Prodhuesit lëshuar për kompaninë tonë.

I.6. Bazuar në nenin 112, pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, nr. Reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si edhe formularin e publikimit me nr. 2700/2 prot., datë 05.12.2022, duke publikuar arsyet e skualifikimit të tij, në procedurën e prokurimit.

I.7. Me shkresën nr. 6342 prot., datë 09.12.2022, protokolluar me tonën me nr. 2700/3, datë 14.12.2022, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Vendimin e KSHA-së për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK.

I.8. Referuar shkresës së mësipërme të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes duke mos e pranuar atë.

I.9 Me aktin me nr.6338, datë 09.12.2022, Komisioni i Shqyrtimit të ankesave pranë autoritetit kontraktor ka argumentuar: *Me gjithë pretendimet e ngritura nga ana e operatorit ekonomik: “AQUARIUS MEDICAL” SHPK Tiranë ankesa nuk merret parasysh pasi po të kalohej në rivlerësim përsëri përfundimi i vlerësimit do të ishte i njëjtë skalifikim për mospërbushje të kriterëve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit. Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK Tiranë nuk është i bazuar në ligj dhe si i tillë nuk merret parasysh.*

I.15. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është paraqitur asnjë argument nga operatorë ekonomikë të interesuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

II.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: *Në lidhje me pikën e parë të skualifikimit të shoqërisë tonë nga kjo procedurë prokurimi, ku keni cituar: “skualifikoheni për arsye se nuk keni përmbushur kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST pasi në katalog paraqitur mungojnë artikujt nr. 6 Shiringa 2cc / Shiringe nje perdorimeshe, steril, me Age 23G, 3 pjesë, dhe artikulli nr.9 Shiringa 50cc/ Shiringe nje perdorimeshe, sterile, me Age 20 G, 3 pjesë; Në katalogun paraqitur për artikujt nr. 7 Shiringa një përdorimshe, sterile me age 22G, 3 pjesë dhe nr. 8 Shiringa një përdorimshe, sterile me age 20G, 3 pjesë nuk përcaktohet madhësia e ages si dhe nuk specifikohet nëse shiringat janë një përdorimshe. Në katalogun e paraqitur për artikullin 10 shiringa insulinë/sterile tre pjesëshe, me age 26 G nuk jepen specifikime teknike të cilat duhet të jenë në përputhje me DST”*

Për sa i përket kësaj pike të skualifikimit nga AK Spitali i Fierit, e kundërshtojmë pasi është në kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik dhe rregullat e prokurimit publik, në lidhje me këto artikuj që keni përmendur, konkretisht artikujt nr. 6, 7, 8, 9 dhe 10, shoqëria jonë ka paraqitur dokumentacionin në SPE ku kemi deklaruar si kompani prodhuese e cila ka lëshuar autorizimin për pjesëmarrje për këto artikuj është Kompania prodhuese Ningbo Greetmed Medical Instruments me origjine në Kinë, e cila ka caktuar si distributor zyrtar për Shqiperine Kompanine Evfarma, ku kjo e fundit si distributor zyrtar ka dhënë autorizimin për

shoqërinë tonë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, ku ndër dokumentet e tjera që kemi paraqitur në SPE është edhe katalogu i artikujve i kompanisë prodhuese Ningbo Greetmed Medical Instruments, ku janë të pasqyruar të gjithë artikujt sipas specifikimeve teknike të parashikuara në DST. Në lidhje me artikujt 6, 7, 8, 9 dhe 10, sqarojmë se këto artikuj janë në katalogun e paraqitur nga ana jonë në SPE dhe konkretisht në file-n me emertimin "16. GREETMED ALL", dhe konkretisht në faqen 33 me kodin GT037-100 për artikujt me nr. 6, 7, 8 dhe 9, dhe me kodin GT037-300 për artikullin nr. 10, artikuj të cilat plotësojnë të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit, si dhe është i perkthyer dhe noterizuar. Këto artikuj kanë të pasqyruara të gjitha specifikimet teknike sipas kerkesave të AK. Gjthashtu për Kompaninë prodhuese Ningbo Greetmed Medical Instruments me origjinë në Kinë në lidhje me artikujt e mësipërm kemi paraqitur edhe dokumnetacionin tjetër shoqërues si ISO, CE dhe DEKLARATAT E KONFORMITETIT ku vërtetojnë standanet ndërkombëtare të cilësisë së artikujve të prodhuar sipas direktivave përkatëse (MDD) për materialet mjekësore.

II.1.1. Në shtojcën 8 “Formular i specifikimeve teknike”, Lot. 2 - Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore (MM2) të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Nr	Artikulli	Specifikime	Njesia
1	Age spinale atraumatike	Pencil point; 22G - 26G; L=7-9cm	Copë
2	Formaldehid	Solucion 35-40%	litra
3	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 2- 0; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioni i ageve 30-40	me age 1/2 rrethore	Copë
4	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 3- 0; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
5	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore	Copë
6	Shiringa 2cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 23G , 3 pjese,	Copë
7	Shiringa 5cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 22 G , 3 pjese,	Copë
8	Shiringa 20cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë
9	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë
10	Shiringa insuline	Sterile, tre pjeseshe, me Age 26G	Copë
11	Sonde rektale		Copë

II.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “MEDI-TEL” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Katalogu Greetmed të artikujve të kompanisë prodhuese.

II.1.3. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

II.1.4. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: *“1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret.

II.1.5 Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

II.1.6. Referuar frymës së legjisllacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim si dhe specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim si dhe specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor dhe specifikimet teknike, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron,

se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

II.1.7. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të specifikimit më sipër operatori ekonomik ka dorëzuar Katalogu të artikujve të kompanisë prodhuese Ningbo Greetmed Medical Instruments i cili është i përkthyer dhe noterizuar.

Nga verifikimi i katalogut të paraqitur nga operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK, KPP vëren se *mungojnë artikujt nr 6 Shiringa 2cc / Shiringe nje përdorimëshe, sterile, me Age 23G, 3 pjese, dhe artikulli nr.9 Shiringa 50cc/ Shiringe një përdorimeshe, sterile, me Age 20 G, 3 pjesë*; Nga verifikimi shtojcën 8 “Formular i specifikimeve teknike”, Lot. 2-Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore (MM2) të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar specifikisht artikujt *Shiringa 2cc / Shiringe nje përdorimëshe, sterile, me Age 23G, 3 pjese, dhe Shiringa 50cc/ Shiringe një përdorimeshe, sterile, me Age 20 G, 3 pjesë*. Komisioni vëren se në katalogun e ngarkuar në sistem rezulton e provuar se në kodin GT037-100 shiringë e disponueshme konstatohet se mungojnë artikujt *Shiringa 2cc/ Shiringe nje përdorimëshe, steril, me Age 23G, 3 pjese, dhe Shiringa 50cc/ Shiringe një përdorimeshe, sterile, me Age 20 G, 3 pjesë*.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se është detyrimi i operatorit ekonomik të vërtetojë që disponon të gjithë artikujt e listuar në dokumentat standarde të tenderit dhe mosplotësimi qoftë edhe i një specifikimi të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “AQUARIUS MEDICAL” SHPK nuk qëndron.

II.2 Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të operatorit ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit më sipër në pikën II.1.6, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik do të vijojë të mbetet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010

“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL”SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-48273-11-02-2022, me objekt “Loti 2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore (MM2)”, me fond limit 1,299,365 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 14.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Fier.
2. Autoriteti kontraktor, lejohe të vijoj me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL”SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro